

SHOQËRIA “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A
ADRESA: RR. “MUHAMET GJOLLESHA”, TIRANË
NUIS J61807025P

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQËRISË “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A.

Sot, më datë 26 janar 2022, në orën 10:00 në Tiranë, Shqipëri, pranë selisë së Shoqërisë “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A., në adresën: “Muhamet Gjollesha”, Tiranë (këtej e tutje “Shoqëria”), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Janë të pranishëm

- Znj. Ajola Arben Xoxa**, dtl. 16/07/1985, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I35716050T, që zotëron që zotëron 2410 aksione të Shoqërisë, apo 19,803 % të kapitalit aksionar, dhe që njëkohësisht ushtron detyrën e Administratores së Shoqërisë;
- Znj. Valbona Xhemil Xoxa**, dtl. 09/10/1958, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal F86008097P, që zotëron 8484 aksione të Shoqërisë, apo 69,712 % të kapitalit aksionar, dhe që vepron në cilësinë e Kryetares së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.


E pranishme është edhe **Znj. Xhoi Skënderasi**, dtl. 08.09.1992, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T që caktohet për të vepruar në cilësinë e Sekretarit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Kryetarja e Asamblesë, Znj. V. Xoxa, deklaron se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur rregullisht, konform ligjt dhe Statutit të Shoqërisë, pa patur ndonjë kundërshtim nga secili prej aksionerëve në lidhje me këtë, për të diskutuar e vendosur mbi Rendin e Ditës së mëposhtëm.

Rendi i Ditës

- Propozimi dhe miratimi i tjetërsimit të pronave/aseteve të Shoqërisë;**
- Të ndryshme.**

Pasi konstaton praninë e të gjithë aksionerëve të sipërpermendur.



1

Deklaron

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë si të mbledhur rregullisht dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

I. PROPOZIMI DHE MIRATIMI I TJETËRSIMIT TË ASETEVE TË SHOQËRISË

Kryetarja e mbledhjes merr fjalën dhe sqaron se Shoqëria disponon disa prona të paluajtshme të cilat që prej regjistrimit të tyre dhe pra privatizimit të shoqërisë në vitin 1996, nuk ishin rivlerësuar asnjëherë dhe si pasojë, ishin ende të regjistruara me një çmim tepër të ulët. Kryetarja sqaron se, në kushte normale, rivlerësimi i pasurisë së shoqërive bëhet me një vlerë tatimi të barabartë me 15%, ndërkohë që aktualisht, një ligj i posaçëm në fuqi (Ligi Nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar) e lejon Shoqërinë të kryejë rivlerësimin e pronave të saj duke paguar vetëm 5%.

Si pasojë, me qëllim kryesisht rivlerësimin e disa pronave të paluajtshme/aseteve të Shoqërisë, proces i cili kërkon investimin e një shume të madhe parash, Shoqëria së fundmi kreu një zmadhim kapitali dhe hyri në një proces rivlerësimi të pronave. Të gjitha shpenzimet avokatore dhe administrative në lidhje me këtë proces kompleks, u mbulan personalisht nga Kryetarja e Asamblesë dhe në fillim të janarit 2022 pronat u rivlerësuan në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke marrë të gjitha aprovimet përkatëse administrative dhe institucionale. Nga llogaria e Shoqërisë u pagua tarifa e rivlerësimit të aseteve, në masën 5%, dhe në zbatim të plotë të pikës 3 të vendimit të Shoqërisë të datës 28.12.2020: "Rivlerësimi i Pronave të Shoqërisë". Shoqëria nuk mundi ta kryejë rivlerësimin e të gjitha pasurive brenda vitit 2020, duke qenë se nuk kishte fonde financiare për të kryer këto veprime, si pasojë, rivlerësimi i parë i dy pronave u krye më datë 03.12.2021 dhe i dyti pas zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, konform vendimit të Shoqërisë së datës 21.06.2021, përkatësisht në datën 12.01.2022, u krye pra rivlerësimi i disa pronave të tjera të Shoqërisë.

Shoqëria ndërkohë ka marrë një ofertë shumë të favorshme lidhur me shitjen e një prej aseteve të Shoqërisë dhe ka lidhur një kontratë paraprake për shitjen e pronës me Nr. Pasurie 5/139-N12 dhe pala ofertuese ka aguar edhe një kapar.

Në vijim Kryetarja i paraqet Asamblesë kontratën paraprake në lidhje me shitjen e pronës me Nr. Pasurie 5/139-N12, lloji Njësi, e ndodhur në Z K. 8210, Vol. 11, Faqe 111, me adresë Bashkia Tiranë, Rruga "Muhamet Gjollesha", me sipërfaqje totale 449.8 m² (katërqind e dyzet e nëntë pikë tetë metra katrorë) e regjistruar rregullisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, vërtetuar nga Certifikata për Vërtetim Pronësie e datës 21.03.2016 me numër serial 1396049.

Në lidhje me Rendin e Ditës, Kryetarja i hedh në diskutim dhe në vijim të deklarimeve të sipërlistuara, pas një diskutimi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

2

VENDOS

1. Miratimin e shitjes së Pronës me Nr. Pasurie 5/139-N12, të përcaktuara në këtë vendim, me çmimin e propozuar në kontratë, i cili është i barabartë me çmimin e listuar sipas listës referencë të çmimeve të zonës. Kjo kontratë është e firmosur dhe e noterizuar sipas ligjit dhe Asambleja e miraton a posteriori kontratën paraprake të lidhur mes Shoqërisë dhe palës ofertuese/blerëse, duke u shprehur e qartë për benefitin që Shoqëria ka në këtë shitje.
2. Autorizimin e Administratores së Shoqërisë, dhe në mungesë të saj çdo person tjetër të autorizuar prej saj, për kryerjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të kërkua nga legjislacioni shqiptar për realizimin e shitjes së pronave/aseteve të lartpërmendura të Shoqërisë si edhe regjistrimin e shitjes apo çdo dokumenti lidhur me shitjen.

II. TË NDRYSHME

Kryetarja pyet të pranishmit nëse kanë ndonjë temë tjetër për të diskutuar.

Kryetarja kujton Asamblenë se Bilanci i vitit 2021 është gati dhe e shpërndan atë tek të pranishmit. Bilanci i Shoqërisë është përgatitur nga auditorja e licensuar / eksperte kontabël Doriana Biba, me NIUS L61803032D.


Duke qenë se të pranishmit nuk kanë tema të tjera për të diskutuar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

VENDOS


1. Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2021 dhe mandaton Administratoren ose një person tjetër të mandatuar prej saj që të kryejë depozitimin e Pasqyrave Financiare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo institucioneve të tjera, sikurse kërkohet nga ligji.
2. Mandatiimin e Administratores së Shoqërisë ose një personi tjetër të autorizuar prej saj me shkrim, që të kryejë regjistrimin e këtij vendimi të Asamblesë së Përgjithshme pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sikurse edhe çdo institucioni tjetër ku mund të jetë e nevojshme; gjithashtu edhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme apo të dobishme me qëllim zbatimin e të gjitha vendimeve të marra në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush tjetër nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaron mbledhjen të mbyllur në orën 12:30.

Znj. Valbona Xoxa



Kryetare e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Znj. Xhoi Skënderasi



Sekretar i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Znj. Ajola Xoxa


Aksionare/Administratore